



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

**PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2019**

**SESIONI I**

**SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT- ORIENTUESE**

**Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi (Kurrikula e vjetër Gjinnaz)**

**Në vëmendje të maturantëve**

**Maturantë,**

Ju mund t'i referoheni skemës së vlerësimit të publikuar nga QSHA, për të verifikuar saktësinë e përgjigjeve tuaja në provimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë. Por, në mënyrë që skema t'ju vijë në ndihmë për të qenë sa më të qartë për arritjet tuaja në provim, duhet të keni parasysh:

- Skema e korigjimit është orientuese (siç parashtrohet edhe në emërtimin e skemës në krye të saj). Kjo do të thotë që:
  - ✓ *për pyetjet me alternativa*, ka vetëm një përgjigje të saktë; të tjerat, edhe pse mund të jenë të përafërta me përgjigjen e saktë, janë të gabuara;
  - ✓ *për pyetjet e hapura*, përgjigjet në skemë nuk janë shtruese, për shkak se shpjegimi apo interpretimi nuk mund të parashkruhet, i plotë dhe i zbërthyer deri në detaje, në një skemë të tillë përmbledhur.
- Gjatë ballafaqimit të përgjigjeve tuaja me përgjigjet në skemë, lexoni me kujdes shënimet për pyetjet me zhvillim, të cilat sqarojnë që përgjigjet tuaja do të vlerësohen me pikë edhe nëse nuk janë pikëpërpikë si përgjigjet që parashikohen në skemë, mjaft që komisioni i vlerësimit t'i pranojë ato si të sakta.

Shpresojmë që sqarimet e mësipërme do t'ju ndihmojnë të fitoni qetësinë e nevojshme në pritje të rezultateve të provimit të shpallura nga QSHA.

**Suksese!**

**PJESA I****Muzika**

|          |   |        |
|----------|---|--------|
| Pyetja 1 | D | 1 pikë |
| Pyetja 2 | A | 1 pikë |
| Pyetja 3 | C | 1 pikë |
| Pyetja 4 | D | 1 pikë |
| Pyetja 5 | D | 1 pikë |
| Pyetja 6 | A | 1 pikë |
| Pyetja 7 | A | 1 pikë |

**Pyetja 8**      **3 pikë****Lloji:**

- informues-paraqitës/ shpjegues.

**Karakteristikat:**

- gjuha është objektive, e drejtpërdrejtë, e qartë, e saktë, pa ngjyime emocionale;
- leksiku është i specializuar, me terma teknikë të fushës përkatëse: *biomuzikë, antropologji, struktura të shumëfishta të trurit njerëzor, “instinkt muzikor”*;
- gjuhë faktike: kemi prezencën e referencave e përkufizimeve: *“Është shumë e thjeshtë të luajmë këngë të pastra, të papërpunuara balenash”, - thotë dr. Grei, e cila ka shkruar një pjesë për saksofon, piano dhe balena.* , apo shpjegim të kuptimit të fjalëve: *biomuzikë, dega që studion bazat biologjike për krijimin dhe vlerësimin e muzikës*;
- fjali të përbëra, me pjesë të lidhura me konektorë të natyrave të ndryshme, që nxjerrin në pah marrëdhëniet mes koncepteve;
- konektorë që sigurojnë lidhjen koherente të paragrafëve (*në fakt, gjithashtu, për shembull*);
- foljet në të tashmen e dëftores (*kanë arritur*) dhe lidhores si dhe në të kryerën e dëftores, për ta paraqitur informacionin si aktual dhe gjithmonë të vlefshëm.

**1 pikë**      Nëse identifikon llojin e tekstit.

**DHE**

**2 pikë**      Nëse identifikon dy karakteristika gjuhësore bashkë me ilustrimet përkatëse.

**OSE**

**1 pikë**      Nëse identifikon një karakteristikë gjuhësore bashkë me ilustrimin përkatës.

**0 pikë**      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:** Nëse ilustrimi mungon, nxënësi nuk do të marrë pikë për këtë pjesë të pyetjes.

**Pyetja 9 (a) 2 pikë****Teza:**

- Muzika është jo vetëm një sipërmarrje e lashtë njerëzore, por edhe një formë arti me interpretues virtuozë nga mbretëria e kafshëve.
- Muzika është veprimtari jo vetëm njerëzore, por shtrihet edhe shumë më gjerë.
- Njerëzit e kanë zhvilluar “instinktin muzikor”, pasi janë ndikuar nga modelet e hasura në botën e kafshëve.

**Argumente:**

- Njerëzit, edhe qindra-mijëra vjet më parë, dinin t’i modelonin instrumentet muzikore, muzika e të cilave ngjason me gagaritjen e rosave.
- Madhështia e zërit, nuk është një cilësi vetëm e njeriut por edhe e një numri kafshësh.

**1 pikë** Nëse identifikon tezën.

**DHE**

**1 pikë** Nëse gjen një argument në mbështetje të saj.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 9 (b) 3 pikë****Vlerësimi:**

Njeriu e a dashur muzikën dhe kjo dashuri është:

- dëshirë e lashtë;
- tipar universal, i përhershëm i qenies njerëzore;
- dëshirë e fortë, e palëkundur.

**Mjeti gjuhësor:**

- mbiemrat.

**Mjeti stilistik:**

- enumeracion: *e jashtëzakonshme, e palëkundur, e papërshkrueshme.*
- epitet: *e lashtë.*

**1 pikë** Nëse tregon vlerësimin që i bëhet dashurisë për muzikën.

**DHE**

**1 pikë** Nëse identifikon mjetin gjuhësor.

**DHE**

**1 pikë** Nëse identifikon mjetin stilistik.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 10**                      **2 pikë****Informacionet:**

- Zbulimet e instrumenteve muzikore në Francë dhe në Slloveni, të cilat datojnë rreth 53 000 vjet më parë.
- Këto zbulime janë dy herë më të vjetra se vizatimet e lashta të zbuluara në shpella.
- Instrumentet janë flaute të gdhendura në kocka kafshësh.
- Studiuesit konstatuan se këto vegla muzikore lëshonin tinguj të ëmbël, të ngjashëm me gagaritjen e rosave.

**Qëllimi :**

- Për të mbështetur argumentin e shtruar në këtë paragraf.
- Për ta bërë më të besueshëm argumentin.

**1 pikë**                      Nëse identifikon një informacion.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse tregon qëllimin e përdorimit të tij.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 11 (a)**                      **1 pikë****Si i mbajnë mend balenat?**

- balenat përdorin ritme dhe fraza muzikore;
- balenat procedojnë me intervale muzikore;
- balenat këndojnë me nota;
- balenat ndjekin një mënyrë të pëlqyer të këngëtarëve, të quajtur forma A-B-A, në të cilën ka një temë që, më pas, përpunohet dhe, në fund, rikthehet në një formë më të modifikuar;
- balenat në këngën e tyre më emocionuese kanë një refren që rimon;
- balenat përdorin rimën, ashtu si edhe ne.

**1 pikë**                      Nëse tregon si i mbajnë mend balenat materialet e tyre komplekse.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 11 (b)**                      **1 pikë****Pse mund të luajmë këngë balenash?**

- Këngët e balenave janë **të thjeshta** dhe **të kuptueshme** nga njerëzit.

**1 pikë**                      Nëse tregon pse njerëzit mund të luajnë këngë balenash.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 12**      **2 pikë****Paragrafi përmbyllës***Përgjigje e plotë*

- Mbyllet me një paragraf të shkurtër, ku vjen një referencë tek dr. Grei, **që përmbyll qëndrimet mbi tezën:** “Ne mund të luajmë këngë të papërpunuara balenash”. Kemi një rikthim tek teza se muzika është formë arti që nuk lidhet vetëm me njeriun.

*Përgjigje e pjesshme*

- Paragrafi përmbyllës risjell edhe një herë tezën.
- Mbyllet me një referencë të Dr. Greit.

**2 pikë**      Nëse analizon në mënyrë të plotë të veçantën e paragrafit përmbyllës.

**1 pikë**      Nëse analizon në mënyrë të pjesshme të veçantën e paragrafit përmbyllës.

**0 pikë**      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**PJESA II****Ismail Kadare***Bjeshkët e namuna në dimër*

|                  |          |               |
|------------------|----------|---------------|
| <b>Pyetja 13</b> | <b>D</b> | <b>1 pikë</b> |
| <b>Pyetja 14</b> | <b>B</b> | <b>1 pikë</b> |
| <b>Pyetja 15</b> | <b>A</b> | <b>1 pikë</b> |
| <b>Pyetja 16</b> | <b>C</b> | <b>1 pikë</b> |
| <b>Pyetja 17</b> | <b>A</b> | <b>1 pikë</b> |
| <b>Pyetja 18</b> | <b>B</b> | <b>1 pikë</b> |

**Pyetja 19 (a)**      **2 pikë****Detajet**

- malet janë “ëndërr veshur në kuarc”;
- luks alpin;
- shkëmbinj si tempuj;
- një varrezë bubullimash;
- gjithçka e ngrirë;
- as zog, as vetëtimë.

**2 pikë**      Nëse identifikon dy detaje.

**OSE**

**1 pikë**      Nëse identifikon vetëm një detaj.

**0 pikë**      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 19 (b) 1 pikë**

- Këto detaje na prezantojnë një natyrë *të ashpër, të bukur, befasuese, tronditëse, të madhërishe dhe të frikshme* njëkohësisht. Kjo natyrë vjen si simbolikë e shqiptarit (njeriut të bjeshkëve) dhe vendit të vet, përgjatë historisë, në luftën e tij për mbijetesë.

**1 pikë** Nëse tregon lidhjen e detajeve me natyrën e shqiptarit dhe vendit të tij.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 20 2 pikë**

**Koha:**

- e tashme.

**Arsyeja e përdorimit:**

- Siguron gjithkohësinë.

**1 pikë** Nëse tregon kohën që kanë foljet në poezi.

**DHE**

**1 pikë** Nëse shpjegon arsyen e këtij përdorimi.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 21 2 pikë**

**E veçanta e ndërtimit sintaksor:**

- Vargjet *Ngrirë gjithçka* dhe *Ëndërr/Veshur në kuarc* janë eliptike (mungon folja).

**Funksioni stilistik:**

- Figura e përdorur është elipsa, siguron ngjeshje të mendimit, ndryshim të ritmit poetik dhe fokusim të vëmendjes së lexuesit më shumë te pamja që ofrohet, se sa të veprimi apo gjendja.

**1 pikë** Nëse gjen të veçantën e ndërtimit sintaksor.

**DHE**

**1 pikë** Nëse shpjegon funksionin stilistik të figurës.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 22**      **3 pikë****Gjendja shpirtërore e heroit lirik:**

- Mahnitje, krenari, adhurim, tronditje, frikë.

**Komenti*****Përgjigje e plotë***

- Heroi lirik është i mahnitur nga pamja e natyrës së bjeshkëve; këtë gjendje e përforcon metafora *ëndërr/veshur në kuarc*. Gjithçka që i shfaqet, i duket e paarritshme, e mrekullueshme, mahnitëse... thjesht i duket sikur është në ëndërr, diçka midis reales dhe irreal. Por hero i lirik njëkohësisht ndihet edhe i mbrojtur, i sigurtë, i paprekshëm në malet shqiptare: metafora/ personifikimi “shiu dot s’i afrohet/luksit alpin”.  
Një ndjenjë tjetër që i shfaqet është edhe krenaria. Ai është pjesë e kësaj lashtësie, bukurie, e force të këtyre maleve – krahasimi: *shkëmbin si tempuj* dhe metafora *një varrezë bubullimash*.

***Përgjigje e pjesshme***

- Figura stilistike si: metafora *ëndërr/veshur në kuarc*, japin imazhin e një hero i lirik me një gjendje shpirtërore të mahnitur nga pamja që shikon.

**OSE**

- Figura letrare si: krahasimi, *shkëmbin si tempuj*, na tregojnë një hero i lirik, krenar për vendin e tij.

**1 pikë**      Nëse identifikon gjendjen shpirtërore të heroit lirik.

**DHE**

**2 pikë**      Nëse komenton në **mënyrë të plotë** mënyrën se si jepet nga ana e poetit kjo gjendje.

**OSE**

**1 pikë**      Nëse komenton në **mënyrë të pjesshme** mënyrën se si jepet nga ana e poetit kjo gjendje.

**0 pikë**      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 23 1 pikë****Simbolika:**

- Shiu simbolizon trazirat që ka kaluar ky vend, në kohëra të ndryshme.

**Imazhi:*****Përgjigje e plotë***

- Imazhi krijohet mbi bazën e një kontrasti kontekstual midis shiut (që nënkupton shqetësimet e kohës) dhe maleve, alpeve (rezistencës). I pari, shiu mund të shfaqet në shumë forma: rrëshqitës, i beftë dhe jo i tillë, i rëndë dhe i butë, i shtruar dhe me bubullima. Kundrejt tij qëndrojnë ato, alpet, të larta, madhështore, ëndërr, të paprekshme, që s'ka ç'u bën asgjë. Në analogji: kjo tokë, këta njerëz, që janë pjesë e saj, i kanë rezistuar çdo lloj "rrebeshi" të kohës.

***Përgjigje e pjesshme***

- Imazhi i krijuar është ai i ballafaqimit të njerëzve të këtij vendi me rrebeshet e kohës.
- Shiu, që nënkupton shqetësimet e kohës, frenohet nga malet e larta.

**1 pikë** Nëse identifikon simbolikën shiut.

**DHE**

**2 pikë** Nëse zberthen në **mënyrë të plotë** nëntekstin që mbart simbolika e shiut.

**OSE**

**1 pikë** Nëse zberthen në **mënyrë të pjesshme** nëntekstin që mbart simbolika e shiut.

**DHE**

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

---



**Pyetja 24**                      **2 pikë****Funksioni që luajnë inversionet:**

- **Inversioni i parë:** *një varrezë bubullimash/ (ke)*. Funksioni që luan ky ndërtim sintaksor i vargut është për të përqendruar vëmendjen në fjalët kyç të vargut: (varrezë) vdekje (bubullimat) - zhurmë, jehonë, djegie, të gjitha këto ndihmojnë situatën paralajmëruese apo kërcënuese.
- **Inversioni i dytë:** *nën këmbë ke* – vëmendja përqendrohet tek rreziku që është fare pranë, si dhe tek karakteri kërcënues i maleve.

**1 pikë**                      Nëse zbërthen funksionin e inversionit të parë.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse zbulon funksionin e inversionit të dytë.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 25**                      **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË****2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton tipin e librit që preferon;
- përdor shembuj dhe ilustrime, fjalët kyç etj, për të mbështetur mendimin e tij në lidhje me çështjen, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve;
- ka qartësi mendimi.

**KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË****2 pikë****1 pikë**                      **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
  - hyrjen;
  - zhvillimin (argumentin/argumentet)
  - përfundimin.

Nxënësi merr **1 pikë**, nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

**1 pikë**                      **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

**KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI****2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- shprehet me një gjuhë eseistike argumentuese, bindëse, subjektive;
- ka fjalor të pasur;
- ka stil origjinal.

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE****2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm;
- ka saktësi drejtshkrimore.